

VENDIM
Nr. 170, datë 28.6.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1 germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/3 prot., datë 23.6.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Egnatia Hydropower’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 121, datë 24.5.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak se në aplikimin e shoqërisë mungonte një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit.

- Me shkresën nr. 636/1 prot., datë 6.6.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen si më sipër, duke i dhënë udhëzimet përkatëse në zbatim të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, duke shpjeguar, se, në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për aplikimin e ri.

- Në përgjigje të sa më sipër (brenda afatit 1-mujor të përcaktuar në rregullore), me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 636/2 prot., datë 10.6.2022, shoqëria ka riparaqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke depozituar dhe dokumentacion shtesë.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “d”;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germa “c”.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2:

- germa “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata); shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e Prokurorisë dhe të Gjykatës për përfaqësuesin e saj ligjor, në bazë të nenit 7, pika 2, germa “b”, të rregullores së licencimit.

- germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse); shoqëria duhet të informojë ERE-n për departamentin që do të merret për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8:

- germa "a" (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në gwh/sipas viteve). Shoqëria duhet të dokumentojë sasitë e parashikuara për t'u tregtuar për pesë vitet e licencës.

- germa "b" (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi vlerën që do të vendosë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 121/2022, për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Egnatia Hydropower" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton se ajo ka depozituar brenda afatit të përcaktuar informacion dhe dokumentacion plotësues, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Egnatia Hydropower" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti